

GJL.Nr.954/2012

REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA E KOSOVES		AGENCIJA PUNDR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PUNDR KORRUPSIONIT	
Libri	DPK/DMP	No. Prot.	03-4524/12
Dep.		Prot. No.	
No. Titull	02	Date	18.12.2012
Isht. / Shprehur		Datum	
No. Dokes		Date	

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Biljana Rexhiq Kryetare, Mejreme Zekaj dhe Ragip Namani, anëtarë, me pjesëmarrjen e sek.juridike Sanije Salihu, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga i pandehuri Smajl Smakiqi nga Mitrovica nëpërmes mbrojtësit të tij avokatit Betim Shala, kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, Regj.I.nr.18232/2012 të dt. 01.08.2012, në bazë të nenit 39, al.3, dhe 221 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 31.10.2012, mori

AKTVENDIM

Ankesa e paraqitur është e bazuar.

NDRYSHOHET aktvendimi i goditur ashtu që ndaj të pandehurit Smajl Smakiqi Pezullohet procedura kundërvajtëse, për kundërvajtje të kryer nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 të ndëshkuar sipas nenit 17 paragrafi 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, e me aplikimin e nenit 11 të Ligjit mbi kundërvajtjet dhe nenit 198 al.1 pika 1 të të njëjtit Ligj. Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

Arsyetim

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, me aktvendimin Regj.I.nr.18232/2012 të dt. 01.08.2012, ka shpall përgjegjës të pandehurin Smajl Smakiqi nga Mitrovica, sepse si zyrtar i lartë publik, në pozitë të Drejtor i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme, nuk e ka bërë deklarin e rregullt të gjendjes së pasurisë në Agjencinë kundër Korrupsionit, brenda afatit ligjor deri më 31.03.2012, me ç,veprim ka kryer kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 të ndëshkuar me nenin 17 paragrafi 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, për të cilën kundërvajtje të pandehurit i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumë prej 2000 Euro. Me të njëjtin aktvendim i pandehuri është i obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj 5 Euro.

Kundër këtij aktvendimi i pandehuri Smajl Smakiqi, nëpërmes mbrojtësit të tij avokatit Betim Shala, ka paraqitur ankesë për shkak të: shkeljeve të dispozitave të procedurës kundërvajtëse, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të drejtës materiale dhe vendimit mbi gjobën e shqiptuar.

Në ankesë përpos tjerash thekson se i pandehuri Smajl Smakiqi me rastin e marrjes së funksionit drejtor i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, ka plotësuar formularin për deklarin e pasurisë dhe të njëjtin e ka dorëzuar më dt.11.11.2011, kamë menduar se ai e ka kryer procedurën për deklarin të pasurisë, dhe nuk ka qenë i njoftuar se ekziston edhe deklarimi i rregullt vjetor, e që edhe ky ka qenë i obliguar ta bëjë këtë deklarin. Me të kuptuar se është obligues për deklarin vjetor më dt.21.05.2012, Agjencionit ia dorëzon formularin me deklarin të pasurisë, por Agjencioni më dt.22.05.2012, ushtron kërkesë për zhvillim të procedurës kundërvajtëse kundër tij. Ka qenë në lajthim, meqë ka menduar se e ka kryer obligimin me rastin e deklarin të pasurisë pas marrjes së funksionit. Ankesës ia ka bashkangjitur edhe vërtetimin mbi deklarin e pasurisë, formularin e fotokopjuar të deklarin të pasurisë, andaj duke pas parasysh rrethanat e lartcekura është propozuar që aktvendimi i goditur të ndryshohet dhe ndaj të pandehurit të Pezullohet procedura kundërvajtëse.

Kolegji i kësaj gjykate vlerësoi thëniet e paraqitura në ankesën e mbrojtësit të pandehurit, deklaratën e dhënë të pandehurit Smajl Smakiqi në seancën e shqyrtimit kryesor pranë gjykatës së shkallës së parë në procesverbal të dt.01.08.2012, i cili e pranon se nuk e ka përmbushur obligimin me kohë ndaj Agjencionit Kundër Korrupsionit, që në afatin ligjor gjerë më 31 mars 2012 ta bëjë deklarin e pasurisë, por meqë me marrjen e funksionit gjatë fundit të vitit 2011, ka bërë deklarin e pasurisë, ka menduar se deklarimi bëhet një herë në vit, por me të kuptuar se është obligues i deklarimit të pasurisë për çdo vit kalendarik më dt.21.05.2012 bënë dhe deklarin e rregullt vjetor të pasurisë, si dhe shkresat e tjera te lendes, andaj, Kolegji ka gjetur se:

Ankesa e paraqitur është e bazuar.

I pandehuri Smajl Smakiqi sipas nenit 8 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtar, ka qenë i obliguar nga dt.01 Mars gjerë më 31 Mars të këtij viti, të bëjë deklarin e rregullt vjetor të pasurisë, meqë i njëjti ushtron funksion publik. Nga shkresat e lëndës, kërkesa e organit kompetent dhe provat tjera, shifet se i njëjti nuk e ka respektuar këtë afat, por deklarimin e pasurisë e ka bërë më dt. 21.05.2012 e kjo vërtetohet nga vërtetimi dhe formulari për deklarim të pasurisë.

Neni 11 i Ligjit mbi kundërvajtjet thekson se nëse kundërvajtja konsiston në mos përmbushjen e obligimit të përcaktuar ose me anë të kundërvajtjes është bërë dëmi pasuror, mund të Pezullohet procedura e kundërvajtjes nëse kryesi i kundërvajtjes para se të merret aktvendimi mbi kundërvajtje e ka përmbushur obligimin e përcaktuar ose e ka kompensuar respektivisht e ka evituar dëmin e shkaktuar, e duke marrë parasysh natyrën e kundërvajtjes vetit personale të kryesit dhe rrethanat nën të cilat është bërë kundërvajtja, dhe mund të pritët që kryesi edhe pa dhënien e dënimit në të ardhmen nuk do të bëjë kundërvajtje.

Nga të gjitha provat që gjendjen në shkresa të lëndës vërtetohet se i pandehuri nuk i ka ikur obligimit për deklarim të pasurisë dhe se obligimin e ka përmbushë pas afatit ligjor të paraparë me Ligj. Meqë i pandehuri ka përmbushë obligimin, andaj Kolegji në mbështetje të nenit 11 al.1 pika 1 të Ligjit mbi kundërvajtjet dhe nenit 198 al.1 pika 1 të njëjtit Ligj e Pezulloi procedurën kundërvajtëse.


Me sa u tha më lartë e në bazë të nenit 221 të Ligjit mbi Kundërvajtjet u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

GJL.Nr.954/2012 të dt.31.10.2012.

SEK.JURIDIKE
Sanije Salihu



KRYETARJA E KOLEGJIT,
Biljana Rexhiq